



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01 - Nr. 16-18737/13.  
Kaçanik, 29.07.2013

**RR E G U L L O R E**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01-Nr. 16-27192/12**  
**- PËR ÇAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE**  
**TRANSFEREVE**

**Korrik, 2013**

Në bazë të nenit 5,12 ,17 dhe 42. 2(a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 qershor 2008), të nenit 6.2, 34.5 dhe 61 të Statutit të komunës së Kaçanikut, i datës 25.09.2008, të nenit 15 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29.07.2013, aprovoj këtë :

**RR E G U L L O R E**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01-Nr. 16-27192/12**  
**-PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE**  
**TRANSFEREVE**

**Neni 1**

**1.1.** Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01- Nr. 16-27192/12 - Për caktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transferëve, e aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut më datën 31.10.2012.

**1.2.** Neni dhe paragrafët e Rregullores që ndryshohen janë paraqitur në nenin 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje, duke u përshkruar teksti ekzistues dhe teksti i cili propozohet të ndryshohet dhe plotësohet (zëvendësohet).

**Neni 2**

**2.1.** Propozohet që te teksti ekzistues te neni 9, Subvencionet për entitete jopublike (familjet dhe individët), të shtohet edhe rastet e mbulimit të shpenzimeve të varrimit:

**Teksti ekzistues:**

Në rast të fatkeqësive natyrore, varfërisë së skajshme të familjeve apo individëve, sëmundjeve të rënda që kanë terapi të kushtueshme e që janë banorë të komunës së Kaçanikut, bursat e studentëve dhe kompensimin e plotë apo të pjesshëm të shpenzimeve të transportit të nxënësve, Kryetari i Komunës na bazë të kërkesave të arsyetuara, ndanë ndihma momentale dhe forma tjera të mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transferëve sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të komunës.

**2.2. Propozohet kompletimi i këtij neni me tekstin e ri :**

Në rast të fatkeqësive natyrore, varfërisë së skajshme të familjeve apo individëve, sëmundjeve të rënda që kanë terapi të kushtueshme e që janë banorë të komunës së Kaçanikut, bursat e studentëve dhe kompensimin e plotë apo të pjesshëm të shpenzimeve të transportit të nxënësve,**si dhe mbulimi i shpenzimeve të krijuara gjatë ceremonisë së varrimit të anëtarit të familjes për të gjitha rastet e paraqitura në territorin e komunës**, Kryetari i komunës na bazë të kërkesave të arsyetuara, ndanë ndihma momentale dhe forma tjera të mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transferëve sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të komunës.

### **Neni 3**

Te neni 12 te kriteret për fitimin e kësaj ndihme u shtohen edhe këto kriteret:

- Dëshmitë valide të nënshkruara nga përfituesi i kësaj ndihme të realizuar përmes Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik,
- Pyetëtori i plotësuar dhe i nënshkruar nga familjari te sektori i Ofiqarisë së Drejtorisë së Administratës Komunale, i bashkangjitur me kopjen e çertifikatës së vdekjes.

### **Neni 4**

**4.1.** Propozohet që në tekstin ekzistues te neni 14, të evidentohet si paragraf 14.1., ndërsa tekstet e reja të propozuara të evidentohen si paragrafi 14.2. dhe 14.3., siç vijon:

#### **4.2. Propozohet teksti ri plotësues si paragrafi 14.2 :**

Për shpenzimet e varrimit për çdo rast do të lejohen mjete në lartësi deri në 150, 00 € dhe se alokimi i mjeteve do të bëhet në dobi të Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik, ndërsa për procedurat dhe format e ndarjes dhe pagesës së këtyre mjeteve financiare nga buxheti i komunës në konton bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame – Kaçanik si dhe ekzekutimin financiar brenda kësaj bashkësie, do të përcaktohen në detaje me akt të veçantë.

#### **4.3. Propozohet teksti ri plotësues si paragrafi 14.3 :**

Financimi i shpenzimeve do të jetë për të gjitha rastet e ndodhura, duke mos i përjashtuar rastet e veçanta kur familjari nuk është i interesuar që këto shpenzime të financohen nga komuna.

### **Neni 5**

Këto ndryshime dhe plotësime dhe do të përfshihen në tekstin bazë të Rregullores komunale 01- Nr. 16-27192/12 - Për caktimin e Kriterëve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.

### **Neni 6**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe publikimit në faqen zyrtare të komunës, ndërsa do të zbatohen duke filluar nga data 01 shtator 2013.

Kryesuesi i Kuvendit,  
Xhelal Gashi

